



BASHKIA  
TIRANË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE**  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, 2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Datë **18/12/2020**

**Nga:** Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë

**Për:** Operatorin ekonomik **Power Industries sh.p.k** me NIPT L51706022H

**Adresa:** Tirane Vore PICAR Tiranë, Vorë, Picar, Zona Kadastrale Nr.3974, Volumi 5, Faqe 143, Sipërfaqe Totale 2610 m2

**Procedura e prokurimit:** Kërkesë për propozim

**Numri i referencës së procedurës:** REF-79412-11-22-2020

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Blerje uniforma dhe veshje speciale për punonjësit e DDD

**Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** deri më 30 ditë nga nënshkrimi

**Fondi Limit:** **6 298 400** (gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind) Lekë pa TVSH

**Burimi i Financimit:** Buxheti i Bashkisë Tiranë

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 03.12.2020

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë, këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

- 1- Operatori ekonomik **POWER INDUSTRIES** sh.p.k me **NIPT L51706022H** me ofertën ekonomike me vlere **6 292 200** (gjashtë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind) **lekë pa TVSH.**
- 2- Operatori ekonomik **MALBERTEX** sh.p.k me **NIPT K71821009N** me ofertën ekonomike me vlere **6 191 600** (gjashtë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) **lekë pa TVSH.**

### **Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

- 1- Operatori ekonomik **MALBERTEX** sh.p.k me NIPT **K71821009N** me ofertën ekonomike me vlere **6 191 600** (gjashtë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) **lekë pa TVSH**.

### **Përkatësisht për arësyet e mëposhtme:**

- **Nuk** plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- **Nuk** plotëson kriteret e veçanta të përcaktuara në DT.
- **Nuk** plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në DT.

**Operatori ekonomik pjesëmarrës nuk ka paraqitur mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion për disa prej produkteve më të rëndësishëm objekt i këtij prokurimi sipas listës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Nisur nga ky fakt Komisioni i Vlerësimit të ofertave vendosi të s'kualifikoj menjëherë operatorin ekonomik pjesëmarrës.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se **oferta nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të **pikës 3 te nenit 66 te VKM-se nr. 914, datë 29.12.2014** “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me **nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006**, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik “**MALBERTEX**” sh.p.k **nuk është në përputhje** me kërkesat e tenderit, duke e cilësuar **si ofertë të pa vlefshme**.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **POWER INDUSTRIES** sh.p.k me NIPT **L51706022H** me ofertën ekonomike me vlere **6 292 200** (gjashtë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind) **lekë pa TVSH**, e paraqitur për tenderin me objekt “**Blerje uniforma dhe veshje speciale për punonjësit e DDD**”, me kohëzgjatje deri **më 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, me adresë; Rruga “5 Maji”, God.17, Tiranë**, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit për lidhjen e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të bëhet anulimi i procedurës së prokurimit siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë 10.12.2020**

**Ankesa: S`ka pasur**

**TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Erindi Bejko**